



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 49, 50 dhe 51 të Ligjit Nr.2004/15 të dt. 27.05.2004 nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-27769/20 dt. 04.02.2020, të investitorit **Burhan Zhdrella** nga fshati Penuhë, Komuna e Podujevës, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste me etazhitet B+P+6, në Lagjen “Tophane” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 07.02.2020 lëshon këtë:

V E N D I M
C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarit/investitorit **Burhan Zhdrella** nga fshati Penuhë, Komuna e Podujevës, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-27769/20 dt. 04.02.2020, për përdorimin e ndërtesës afariste, me etazhitet **B+P+6**, e ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale nr.-05866-0, Zona Kadastrale Prishtinë, blloku urban T20, Lagja “Tophane”, sipas Vendimit numër 05 Nr. 351-21231 dt. 26.09.2007 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-21231 dt. 26.09.2007, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përkthyer në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronari/investitori Burhan Zhdrella nga fshati Penuhë, Komuna e Podujevës, më kërkesën me 09 Nr. 391/02-27769/20 dt. 04.02.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimin e ndërtesës afariste, me etazhitet B+P+6, në lokacionin e përkthyer si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-21231 dt. 26.09.2007 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës afariste me etazhitet B+P+6 të pronarit/investitorit Burhan Zhdrella nga fshati Penuhë, Komuna e Podujevës, në kuadër të ngastrës kadastrale nr. 05866-0, Zona Kadastrale Prishtinë, në kuadër të bllokut urban T20 , Lagja “Tophane”, në rrugën “UÇK” .

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-21231 dt. 26.09.2007 mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore të pronarit/investitorit Burhan Zhdrella nga fshati Penuhë, Komuna e Podujevës.
- Lejen Urbanistike nr. 05 Nr. 350-6942 dt. 25.09.2007 mbi kushtet tekniko-urbanistike për ndërtimin e objektit investiv në ngastrën kadastrale 05886-0, Zona Kadastrale Prishtin, në rrugën "UÇK, Lagja "Tophane".
- Kushtet Urbanistike të lokacionit të bllokut "T20 të Planit Rregullativ "Tophane" të miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 Nr.35-579 të dtës 22.11.2005.
- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit me numër 05-351/04-18830/20 të datës 29.01.2020.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht raportin e komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës të ndërtimit të ndërtesës dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e investitorit, ka konstatuar se:

Ndërtesa afariste është ndërtuar në pajtim me Venimet e cekura më lartë dhe dokumentacionit tjetër teknik dhe se i njëjti i përmush normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të ndërtesave të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtorja e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës t'a lëshoj Certifikatën e Përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-27769/20 DT. 07.02.2020**

Zyrtari:

Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi

